



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

**VENDIM**

*Nr.12, Datë 23.01.2020*

**MBI**

**DISA NDRYSHIME NË KONTRATËN E SHITBLERJES SË ENERGJISË  
ELEKTRIKE MES SHOQËRISË SË NGARKUAR ME DETYRIMIN E SHËRBIMIT  
PUBLIK PËR BLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA  
PRODHUESIT ME PËRPARËSI**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 20, germa h) të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, VKM nr. 883, datë 27.12.2019 “Mbi disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 244, datë 30.03.2016 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 23.01.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Çështjeve Ligjore, nr. 14/1 prot., datë 15.01.2020 në lidhje disa ndryshime në kontratën e shitblerjes së energjisë elektrike mes shoqërisë së ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit me përparësi, miratuar me Vendimin e Bordit nr. 101, datë 23.06.2016, i ndryshuar,

**Konstatoi se:**

- Me Vendimin nr. 101, datë 23.06.2016 të Bordit të ERE-s, është miratuar Kontrata për shit-bletjen e energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike.
- Kjo vendimmarrje e ERE në vijim ka pësuar ndryshime e shtesa me vendimet e Bordit të ERE me Vendimin nr. 147, datë 30.09.2016, si dhe me Vendimin nr. 255, datë 24.12.2018.
- Së fundmi Këshilli i Ministrave ka miratuar me VKM nr. 883, datë 27.12.2019 disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 244, datë 30.3.2016, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar.
- Konkretisht në nenin 11, pika 2 të VKM-së nr. 883, datë 27.12.2019, sipërcituar, është sanksionuar se: 2. Detyrimi i shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë i vendoset shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kontratën tip, të miratuar nga ERE. Duke qenë se ndryshimet në kontratën tip vijnë si detyrim i VKM-së nr. 883, datë 27.12.2019, nuk nevojitet që t’i nënshtrohen një procedure konsultimi. Kontratat ekzistuese që OSHEE sh.a. ka me prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike do të transferohen te furnizuesi i tregut të lirë, bazuar në aktet e

brendshme ligjore/administrative ndërmjet shoqërive.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

**Vendosi:**

1. Në kontratën e shitblerjes së energjisë elektrike mes shoqërisë së ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit me përparësi, bëhen ndryshimet si vijon :
  - a) Kudo në kontratë OSHEE sh.a. në cilësinë e të ngarkuarit me detyrimin e shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë do të zëvendësohet me shoqërinë publike të furnizimit në tregun e lirë FTL sh.a.
  - b) Në fund të pikës 1 të Nenit 10 togfjalëshi “të OSHEE Sh.a” bëhet me Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a.”
  - c) Në fund pikës 3 të nenit 13 shtohet togfjalëshi “me Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes”
2. Për subjektet që kanë një kontratë të shitblerjes së energjisë elektrike me OSHEE sh.a. para apo në kohën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi të ERE, kontrata për shitblerjen e energjisë elektrike me shoqërinë publike të furnizimit në tregun e lirë FTL sh.a., do të lidhet për periudhën e mbetur nga përfundimi i kontratës së lidhur me OSHEE sh.a.
3. Fuqia juridike e kontratës së ndryshuar me këtë vendim, lidhur mes FTL sh.a. dhe çdo prodhuesi me përparësi të energjisë elektrike për shitblerjen e energjisë elektrike, i shtrin efektet nga data e hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve dhe deri në përfundimin e afatit të parashikuar në kontratat respektive të lidhura.
4. Të monitorohet jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi ecuria e procesit të transferimit të kontratave ekzistuese që OSHEE sh.a. ka me prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike te Furnizuesi i Tregut të Lirë, FTL sh.a.
5. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë palët e interesit, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**